1. Lejohet pagesa e faturës Nr. 0038074 e datës 06.02.2026, me kuponin fiskal Nr. 0020 në shumë prej 95.40 € për shpenzimet e krijuara në Fast Fod "Linda" në Kamenicë, me rastin e organizimit të një dreke pune me zyrtarë nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës për projektet infrastrukturore në Komunën e Kamenicës, për mysafirët e ftuar është shtruar drekë me vlerë prej 95.40 €, si pjesë e pritjes zyrtare dhe në shenjë mirëseardhjeje e respekti ndaj tyre.

2. Pagesa të bëhet nga kodi buxhetor 18189 i DSHPAIE-së, në xhirollogarinë bankare të paraqitur në faturë e cila është e bashkangjitur në shtojcë të këtij vendimit.

3. Zbatimin e vendimit e bënë Drejtoria e Financave dhe Buxhetit në Kamenicë në pajtim me dispozitat e nenit 12 paragrafi 12.4 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

4. Vendimit i fatura Nr. 0038074 e datës 06.02.2026, me kuponin fiskal Nr. 0020 në shumë prej 95.40€.

5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendim t`i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- DSHPAIE-së;
- DBF-së; dhe
- QSHQ – Arkivit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E KAMENICËS
02 KRYETARI I KOMUNËS
PREDSEDNIK OPŠTINE
OPŠTINA KAMENICA
REPUBLIKA KOSOVA

Kryetar i Komunës

Kadri Rahimaj

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KAMENICËS - OPSTINA KAMENICA
KAMENICA MUNICIPALITY
QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARË
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS
SH./Z./S. 02 Nr./Br./No. 3918
Nr. Faq. / Br. Str. / No. Pg 2 Data / Datum / Date 12/02 2026
KAMENICË - KAMENICA

Zyra e Kryetarit
Sh.02.Nr.21, datë: 10.02.2026

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28, datë 4 qershor 2008), nenin 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenet 23, 24 dhe 25 të Rregullores MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, nenet 27 dhe 29 të Rregullores Sh.01.Nr.31251, datë 29.09.2022, për kushtet, kriteret dhe procedurën e ndarjes së subvencioneve, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Sh.01.Nr.8620, datë 14.04.2025, Thirrjes Publike Sh.13.Nr.2218, datë 28.01.2025, për mbështetje financiare për projekte rinore, si dhe Thirrjes Publike Sh.13.Nr.2222, datë 28.01.2025, për mbështetje financiare për projekt-propozimet e OJQ-ve për organizimin e aktiviteteve kulturore në Komunën e Kamenicës, si dhe nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja b) të Statutit Sh.01.Nr.20203, datë 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

1. **FORMOHET** Ekipi Monitorues për projektet/programet e mbështetjes financiare publike të projekteve të OJQ-ve për vitin 2025, sipas Thirrjes Publike Sh.13.Nr.2218, datë 28.01.2025, për mbështetje financiare për projekte rinore, si dhe Thirrjes Publike Sh.13.Nr.2222, datë 28.01.2025, për mbështetje financiare për projekt-propozimet e OJQ-ve për organizimin e aktiviteteve kulturore në Komunën e Kamenicës, me këtë përbërje:

   1.1. Shehat Rrudhani (DKRS) – kryesues;
   1.2. Vjollca Azemi (DBF) – anëtare;
   1.3. Selmon Kryeziu (DBF) – anëtar;
   1.4. Enis Fazliu (ZK) – anëtar; dhe
   1.5. Ajshe Hoda Thaqi (DKRS) – anëtare.

2. Anëtarët e Ekipit të formuar sipas pikës (1) të këtij Vendimi do të veprojnë në përputhje me Rregulloren MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

3. Anëtarët e Ekipit Monitorues obligohen të bëjnë monitorimin dhe të sigurojnë informacione mbi rregullsinë e shpenzimit të fondeve publike, realizimin e aktiviteteve të projekteve në tërësi, si dhe rezultatet e arritura përmes zbatimit dhe ndikimit të projekteve.

4. Zbatimin e këtij Vendimi e bën Ekipi Monitorues, sipas pikës (1) të këtij Vendimi, ndërsa mbikëqyrjen e zbatimit e bën Kryetari i Komunës.

5. Mandati i Ekipit Monitorues të formuar me këtë Vendim zgjat deri në përfundimin e plotë të monitorimit të projekteve/programave për të cilat është formuar, përfshirë dorëzimin e

raporteve përfundimtare.

6. Këtij Vendimi i bashkëngjiten kopjet e Thirrjes Publike Sh.13.Nr.2218, datë 28.01.2025, për mbështetje financiare për projekte rinore, si dhe Thirrjes Publike Sh.13.Nr.2222, datë 28.01.2025, për mbështetje financiare për projekt-propozimet e OJQ-ve për organizimin e aktiviteteve kulturore në Komunën e Kamenicës.

7. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi t'i dorëzohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Anëtarëve të Ekipës Monitoruese, Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe QSHQ – arkivit.

Kryetar i Komunës

Kadri Rahimaj

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KAMENICËS - OPŠTINA KAMENICA
KAMENICA MUNICIPALITY
QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARË
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS
SH./Z./S. 02 Nr./Br./No. 4204
Data/Datum/Date 16/02/2026
KAMENICË - KAMENICA

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

Zyra e Kryetarit
Sh.02.Nr.24, datë: 13.02.2026

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, në nenet 44 dhe 53, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 20/2016), në nenin 12, paragrafi 1, të Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës, në nenet 17 dhe 29 të Rregullores Sh.01.Nr.31251, datë 29.09.2022, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurën e Ndarjes së Subvencioneve, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Sh.01.Nr.8620, datë 14.04.2025, në bazë të Thirrjes Publike Sh.12.Nr.4928, datë 03.03.2025, për mbështetjen e bizneseve të vogla dhe start-up në zgjerimin e kapaciteteve prodhuese, përpunuese dhe shërbyese që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik lokal, si dhe në nenin 70, paragrafi 70.1, shkronja b), të Statutit Sh.01.Nr.20203, datë 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

1. **FORMOHET** Komisioni Monitorues për mbështetjen e bizneseve të vogla dhe start-up në zgjerimin e kapaciteteve prodhuese, përpunuese dhe shërbyese që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik lokal, sipas Thirrjes Publike Sh.12.Nr.4928, datë 03.03.2025, me këtë përbërje:

    1.1. Valdete Sopi (DZHED), kryesuese;
    1.2. Edon Canaj (DBF), anëtar;
    1.3. Vlera Bugaqki (QPS), anëtare;
    1.4. Bashkim Krasniqi (DZHED), anëtar; dhe
    1.5. Floriana Grabovci Mavriqi (ZK), anëtare.

2. Anëtarët e Komisionit Monitorues duhet të bëjnë monitorimin dhe të sjellin informacione mbi realizimin e projektit për të cilin janë ndarë mjetet, duke verifikuar në terren zbatimin e tij, kontrolluar dokumentacionin financiar dhe dëshmitë përkatëse lidhur me shpenzimin e mjeteve, vlerësuar përputhshmërinë e realizimit të projektit me kontratën, si dhe duke evidentuar shkeljet eventuale dhe mospërputhjet në realizim.

3. Komisioni Monitorues është i obliguar të hartojë raport për secilin përfitues dhe të propozojë masa përkatëse në rast të mosrespektimit të kontratës, përfshirë edhe propozimin për përfshirjen e përfituesve në listën e zezë në rast të konstatimit të shkeljeve serioze apo mospërmbushjes së obligimeve kontraktuale, në pajtim me kriteret e përcaktuara në Rregulloren Sh.01.Nr.31251, datë 29.09.2022, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurën e Ndarjes së Subvencioneve, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Sh.01.Nr.8620, datë 14.04.2025, si dhe në bazë të Thirrjes Publike Sh.12.Nr.4928, datë 03.03.2025, për mbështetjen e bizneseve të vogla dhe start-up në zgjerimin e kapaciteteve prodhuese, përpunuese dhe shërbyese që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik lokal.

4. Zbatimin e këtij vendimi e bën Komisioni Monitorues, siç është përcaktuar në pikën (1) të këtij vendimi, ndërsa mbikëqyrjen e zbatimit të tij e bën Kryetari i Komunës.

5. Mandati i Komisionit Monitorues zgjat deri në përfundimin e plotë të monitorimit të mbështetjes së bizneseve të vogla dhe start-up në zgjerimin e kapaciteteve prodhuese, përpunuese dhe shërbyese që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik lokal sipas Thirrjes Publike Sh.12.Nr.4928, datë 03.03.2025, si dhe dorëzimin e raporteve përfundimtare.

6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, ***shfuqizohen*** vendimi Sh.02.Nr.1714, datë 16.01.2024, dhe vendimi Sh.02.Nr.14610, datë 07.05.2024.

7. Bashkëngjitur këtij Vendimi është Thirrja Publike Sh.12.Nr.4928, datë 03.03.2025, për mbështetjen e bizneseve të vogla dhe start-up në zgjerimin e kapaciteteve prodhuese, përpunuese dhe shërbyese që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik lokal, Vendimi Sh.02.Nr.1714, datë 16.01.2024, dhe Vendimi Sh.02.Nr.14610, datë 07.05.2024.

8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi t'i dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- Anëtarëve të Komisionit;
- Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë; dhe
- QSHQ – arkivit.

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj

KOMUNA E KAMENICËS - OPŠTINA KAMENICA
KAMENICA MUNICIPALITY
QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARË
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS
SH./Z. /S. 02 Nr./Br./No. 4278
Data/Datum/Date 16/02/26
KAMENICË - KAMENICA

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

Zyra e Kryetarit
Sh.02.Nr.26, datë: 16.02.2026

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 70 pika b) të Statutit Sh.01.nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, si dhe Kërkesa Sh.02.Nr.4110 e datës 13.02.2026 për realizimin e manifestimit të përvjetorit të Pavarsisë së Republikës së Kosovës e parashtruar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryetari i Komunës nxjerrë këtë:

VENDIM
PËR LEJIMIN E PAGESËS NË VLERË PREJ 1,900.00 €

1. Lejohet pagesa e shpenzimeve për organizimin e manifestimit në kuadër të përvjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës, në shumën prej 1,900.00 € (Një mijë e nëntëqind euro).

2. Në kuadër të këtij manifestimi janë organizuar aktivitetet e mëposhtme:

   2.1 Turneu tradicional i pingpongut; dhe
   2.2 Turneu tradicional i shahut;

3. Pagesa të bëhet nga kodi buxhetor 85029 i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Financave dhe Buxhetit në Kamenicë.

5. Vendimit i bashkangjitet Kërkesa Sh.02.Nr.4110 e datës 13.02.2026, e Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport në Komunën e Kamenicës dhe lista e Aktiviteteve.

6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, DFB-së, DKRS-së dhe QSHQ-arkiv.

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAMENICËS 02 KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE KAMENICA

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KAMENICËS - OPŠTINA KAMENICA
KAMENICA MUNICIPALITY
QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARË
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS
Sh./Z./S. 02 Nr./Br./No. 4434
Nr. i faq. Br. str. No. Pg 3 Data/Datum/Date 18/02/2026
KAMENICË - KAMENICA

Zyra e Kryetarit
Sh.02.Nr.25, datë: 16.02.2026

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, nenin 12 dhe nenin 13, Udhëzimit Administrativ Nr.21/2010 për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit, Udhëzimit Administrativ Nr.22/2010 për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta për banim, Udhëzimit Administrativ Nr.18/2010 për përmbajtjen e kontratës për banesën me qira joprofitabile, Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2025, Ligjin Nr. 08/L-302 për Ratifikimin e Marrëveshjen të Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE/CEB), si dhe Marrëveshjet e Mirëkuptimit në mes MMPHI dhe Komunës së Kamenicës për zbatimin e Projektit të Banimit Social Adekuat, si dhe në nenin 70, paragrafi 70.1, shkronja b), të Statutit Sh.01.Nr.20203, datë 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, duke marrë parasysh nevojën për organizim dhe menaxhim të efektshëm të nën-projekteve për renovimin e Ndërtesës së Banimin Social në territorin e Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM

Për themelimin e Komisionit Vlerësues për verifikimin e gjendjes ekonomike të familjes/individit të vendosur në njësi të banimit në kuadër të Ndërtesës së Banimit Social

Neni 1
Themelimi i Komisionit

1. Në kuadër të Komunës së Kamenicës, themelohet Komisioni Vlerësues për verifikimin e gjendjes ekonomike dhe sociale për njësitë e banimit në Ndërtesën e Banimit Social, në kuadër të obligimeve të Komunës për menaxhimin e njësive të banimit social.

2. Komisioni Vlerësues për verifikimin e gjendjes ekonomike dhe sociale do të funksionojë si organ kompetent komunal për verifikimin e gjendjes ekonomike të familjeve/individëve në njësitë e banimit të Ndërtesës së Banimit Social.

Neni 2
Përbërja

1. Komisioni përbëhet nga tre (3) anëtarë të emëruar nga drejtoritë reprezentative të administratës komunale (urbanizëm, mirëqenie sociale dhe shëndetësi, buxhet/financa):

    1.1. Faton Biqkaj (QPS), Kryesues i Komisionit;
    1.2. Arif Skoverqani (DUPH), anëtar; dhe
    1.3. Merita Kryeziu (DBF), anëtare.

Neni 3
Detyrat dhe Përgjegjësitë

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisioni Vlerësues janë:

1.1. Njoftimi i familjes / individit të vendosur në njësi të banimit në kuadër të Ndërtesës së Banimit Social për aplikimin e detyrueshëm për verifikim të gjendjes ekonomike-sociale bazuar në nenin 12 të Ligjit Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit. Njoftimi duhet të vendoset në hyrje të ndërtesës së Banimit Social në koordinimin me administratorin e ndërtesës, si dhe në tabelën e njoftimeve të Ndërtesës Komunale, dhe Qendrën për Punë Sociale. Periudha e aplikimit të familjes/individit mbetet e hapur 15 ditë kalendarike, me dorëzim të aplikacionit pranë Komisionit në ndërtesën komunale.

1.2. Verifikimi i gjendjes ekonomike për familjet/individët e vendosur në njësi të banimit në kuadër të ndërtesës së banimit social, duke përfshinë shqyrtimin e Formës së kërkesës dhe dokumentacionin e nevojshëm (shtojca 1 dhe shtojca 2 e Udhëzimit Administrativ nr. 23/2010 për procedurat e shpalljes së programeve të veçanta të banimit), si dhe intervistimin dhe vlerësimin në terren, sipas nevojës.

1.3. Pas përfundimit të verifikimit dhe vlerësimit, Komisioni Vlerësues përgatitë raportin përfundimtarë dhe është i obliguar të njoftojë familjen/individin për rezultatet e verifikimit të gjendjes ekonomike, në përputhje me nenin 12, paragrafi 4, të Ligjit Nr. 03/L-164.

1.4. Në rast se gjatë verifikimit konstatohet se familja nuk i plotëson më kriteret për përfitim, Komisioni Vlerësues i propozon organit kompetent shkëputjen e kontratës së qirasë, në përputhje me nenin 13, të Ligjit Nr. 03/L-164.

1.5. Komisioni Vlerësues është i detyruar të zbatojë kriteret e përcaktuara me Udhëzimin Administrativ Nr.21/2010, duke respektuar rendin e përparësisë për kategoritë e familjeve përfituese, Udhëzimi Administrativ Nr. 22/2010 "Për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta të banimit dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 23/2010 "Për procedurat e shpalljes së programeve të veçanta të banimit".

Neni 4
Zbatimi i Vendimit

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe zbatimi i tij është i obligueshëm për të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues.

T'i dorëzohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Anëtarëve të Komisionit dhe QSHQ-arkivit.

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KAMENICËS - OPŠTINA KAMENICA
KAMENICA MUNICIPALITY
QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARË
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS
SH./Z./S. 02 Nr./Br./No. 4450
Nr. faq Br. str. No Pg 1 Data Datum Date 18/02 2026
KAMENICË - KAMENICA

Zyra e Kryetarit
Zyra e Prokurimit
Sh.02.Nr.10 datë:18.02.2026

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, nenit 70 paragrafi 70.18 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, datë 20.10.2022, Kontratës Sh.02 Nr. 2553 e datës 28.01.2026, si dhe nenit 70 paragrafi 70.1 pika b) të Statutit Nr. Sh.01.nr.20203, datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës nxjerr këtë:

VENDIM

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrës i drejtpërdrejtë e menaxherit të kontratës me titull: **"Furnizim me material sanitar dhe material-pajisje tjera"**, me numër të kontratës **KM 653-25-10022-1-2-1** si në vijim:

   1.1. **Z. Burim Mavriqi** (DAP), **CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

   1.2 **Z.Besnik Kovani** (DAP), **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë e menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë e menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

T'i dërgohet:
- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Burim Mavriqi (DAP);
- z. Besnik Kovani (DAP); dhe
- QSHQ-arkiv

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - KOMUNA E KAMENICËS - OPŠTINA KAMENICA - 02 KRYETARI I KOMUNËS - PREDSEDNIK OPŠTINE

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E KAMENICËS
OPŠTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KAMENICES - OPŠTINA KAMENICA
KAMENICA MUNICIPALITY
QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARË
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS
SH./Z. /S. 02 Nr./Br./No. 4470
Nr. faq. / Br. str. / No. Pg 01 Data / Datum / Date 18/02/2026
KAMENICË - KAMENICA

Nr:49 /2026
Datë: 28.02.2026

Në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe të Shpalljes Publike Nr.02/3374 të datës 06.02.2026 për pozitën: Zyrtar Administrativ në Zyrën e Kryetarit . Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS

1. Formohet Komisioni për përzgjedhjen e kandidatëve për pozitën:Zyrtar Administrativ në këtë përbërje:

   1.1.Valdete Berisha Murina, Kryesuese;
   1.2 Riad Rahimaj, anëtarë;
   1.3. Liridon Rexhepaj, anëtarë;

2. Komisioni do t`i vlerësojë të gjithë kandidatët pas intervistimit, rekomandon kandidatët që kanë treguar rezultate më të mira gjatë intervistimit

3. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi t`i dergohet:
- Zyrës së Kryetarit
- Zyrës së Personelit
- Anëtarëve të Komisionit

Kadri RAHIMAJ

Kryetar i Komunës së Kamenicës

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KAMENICËS - OPŠTINA KAMENICA
KAMENICA MUNICIPALITY
QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS
SH./Z./S. 02 Nr./Br./No. 4950
Nr. i faq. / Br. Str. / No. Pg. 1 Data / Datum / Date 23/02/2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

Zyra e Kryetarit
Zyra e Prokurimit
Sh.02 nr.13 datë: 23.02.2026

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 22 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092, nenin 10 paragrafi 10.1 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, si dhe bazuar në Deklaratën përkatëse të Nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve për projektin **"Rehabilitimi i kanalizimit atmosferik përgjatë rrugës kryesore Rafet Isufi – Koretin"** dhe nenin 70 paragrafi 70.1 pika b) të Statutit nr. Sh.01.nr.20203, datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës nxjerr këtë:

V E N D I M

1. CAKTOHET, **z. Zotrim Kastrati** , Zyrtar Autorizues për projektin: **"Rehabilitimi i kanalizimit atmosferik përgjatë rrugës kryesore Rafet Isufi – Koretin"** Zyrtari Autorizues nga pika (1) një e këtij Vendimi nuk e autorizon Zyrtarin e Prokurimit që të inicioj aktivitetin e propozuar të prokurimit para se ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) i autoritetit kontraktues t'i ketë dorëzuar Zyrtarit autorizues Deklaratën përkatëse të nevojave dhe vendosshmërisë për disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara nga ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) dhe ZKF (Zyrtari Kryesor Financiar) i autoritetit kontraktues.

2. Pas konstatimit të përmbushjes së kushteve të parapara sipas pikës (2) të këtij Vendimi, Zyrtari Autorizues autorizon inicimin e aktivitetit të prokurimit përmes dorëzimit te Zyrtari i Prokurimit të një udhëzimi me shkrim për inicimin e aktivitetit të prokurimit, së bashku me kopjen e Deklaratës së Nevojave dhe Vendosmërinë për Disponueshmërinë e Fondeve.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi është përgjegjës Zyrtari Autorizues, z. **Zotrim Kastrati**, për projektin: **"Rehabilitimi i kanalizimit atmosferik përgjatë rrugës kryesore Rafet Isufi – Koretin"**

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari Komunës.

Vendimi t'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z.Zotrim Kastrati (DSHPAIE); dhe
- Arkivi.

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAMENICËS 02 KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE REPUBLIKA KOSOVA OPŠTINA KAMENICA

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KAMENICËS - OPŠTINA KAMENICA
KAMENICA MUNICIPALITY
QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARË
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS
SH./Z./S. 02 Nr./Br./No. 494
Nr. Fag. Br. Str. No. Pg. 2 Data/Datum/Date 24/02/2026
KAMENICË - KAMENICA

Zyra e Kryetarit
Sh.02Nr.29,datë:24.02.2026

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008); të nenit 29, 30, 31 dhe nenit 53, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 20/21 qershor 2016); të nenit 12, paragrafi 1, të Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës; Vendimit Sh.02.Nr.26982, të datës 07.09.2021, për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në Komunë ndaj vendimeve të Inspektoratit Komunal në lëmin e mjedisit, ujërave, natyrës dhe planifikimit hapësinor; Vendimit Sh.02.Nr.2412, të datës 22.01.2024, për plotësim-ndryshimin e Vendimit Sh.02.Nr.26982, të datës 07.09.2021; Deklarimit të Konfliktit të Interesit Sh.02.Nr.34041, të datës 09.12.2025, nga zyrtari i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, z. Hasan Keqmezi, njëherësh edhe kryesues i Komisionit sipas Vendimit Sh.02.Nr.26982, të datës 07.09.2021; si dhe nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja h), të Statutit Sh.01.Nr.20203, të datës 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Sh.02.Nr.26982, të datës 07.09.2021, "Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave ndaj vendimeve të Inspektoratit Komunal në fushën e mjedisit, ujërave, natyrës dhe planifikimit hapësinor"

1. Paragrafi 1 (një), nënparagrafi 1.1 (një pikë një) i Vendimit Sh.02.Nr.26982, të datës 07.09.2021, "Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në Komunë ndaj vendimeve të Inspektoratit Komunal në lëmin e mjedisit, ujërave, natyrës dhe planifikimit hapësinor", ndryshohet dhe plotësohet si në vijim: Në vend të kryesuesit të Komisionit, z. Hasan Keqmezi (DBF), caktohet kryesues i Komisionit z. Alban Hashani (ZK), dhe riformulohet me këtë përbërje, si në vijim:

   1.1. Alban Hashani (ZK), Kryesues i Komisionit;

   1.2. Zijadin Thaqi (ZK), anëtar; dhe

   1.3. Arif Skoverqani (DUPH), anëtar.

2. Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit bazë Sh.02.Nr.26982, të datës 07.09.2021, "Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në Komunë ndaj vendimeve të Inspektoratit Komunal në lëmin e mjedisit, ujërave, natyrës dhe planifikimit hapësinor".

3. Këtij vendimi i bashkëngjiten: kopja e Vendimit Sh.02.Nr.26982, të datës 07.09.2021, "Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në Komunë ndaj vendimeve të Inspektoratit Komunal në lëmin e mjedisit, ujërave, natyrës dhe planifikimit hapësinor"; Vendimi Sh.02.Nr.2412, të datës 22.01.2024, për plotësim-ndryshimin e Vendimit Sh.02.Nr.26982, të datës 07.09.2021; si dhe Deklarimi i Konfliktit të Interesit

Sh.02.Nr.34041, të datës 09.12.2025, nga zyrtari i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, z. Hasan Keqmezi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me vendim të njoftohet: Zyra e Kryetarit, Zyra e Informimit, z. Hasan Keqmezi (DBF), z.Alban Hashani (ZK), Anëtarëve të Komisionit sipas Vendimit Sh.02.Nr.26982, të datës 07.09.2021 dhe Q.SH.Q - arkivit.

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KAMENICËS - OPŠTINA KAMENICA
KAMENICA MUNICIPALITY
QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS
SH./Z./S. 02 Nr./Br./No. 5130
Nr. i fiq. / Br. str. / No. Pg 1 Data / Datum / Date 25/02
KAMENICË - KAMENICA 2026

Zyra e Kryetarit
Zyra e Prokurimit
Sh.02.Nr.14 datë:24.02.2026

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, nenit 70 paragrafi 70.18 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Vendimit Sh.02, Nr. 25411, datë 04.03.2025 për caktimin e menaxherit dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të kontratës, si dhe nenit 70 paragrafi 70.1 pika b) të Statutit Nr. Sh.01.nr.20203, datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenica, Kryetari i Komunës së Kamenicës nxjerr këtë:

V E N D I M
Për ndryshim dhe plotësim të Vendimit Sh.02, Nr. 25411, datë 04.03.2025

1. **NDRYSHOHET** paragrafi 1.1 e pikës 1 të Vendimit Sh.02, Nr 25411 i datës 04.03.2025 për caktimin e menaxherit dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të kontratës me titull **"Lot 12 – Transporti i nxënësve të fshatit Hohosht – Lagjja Xhaqkaj dhe fshati Kopernicë për Gjimnazin Ismail Qemali dhe IAPP 'Andrea Durrsaku"** ***riformulohet*** si në vijim:

   1.1 Në vend të: z. Selami Klaiqi (Drejtor i "Gjimnazit Ismail Qemali"), CAKTOHET menaxher i Kontratës.
   Vendoset: z. Agon Mahmuti, (Ushtrues Detyre në IAPP Andrea Durrsaku), CAKTOHET menaxher i Kontratës.

2. Të gjitha dispozitat tjera të Vendimit Bazë Sh.02, Nr. 25411, datë 04.03.2025 mbesin në fuqi.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe është pjesë përbërëse e Vendimit.

Shtojcë: Kopja e Vendimit Bazë Sh.02, Nr. 25411, datë 04.03.2025,

T'i dërgohet:
- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- Z. Selami Klaiqi (DKA)
- Z.Agon Mahmuti (U.D. në IAPP "Andrea Durrsaku")
- QSHQ-arkivi.

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAMENICËS KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE KAMENICA

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KAMENICËS - OPSTINA KAMENICA
KAMENICA MUNICIPALITY
QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARË
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS
SH./Z.S. 02 Nr./Br./No. 5358
Nr. i faq. / Br. Str. / No. Pg 2 Data / Datum / Date 27/02/2026
KAMENICË - KAMENICA

Zyra e Kryetarit
Sh.02.Nr.30, datë: 26.02.2026

Në bazë të neneve 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja b) të Statutit Sh.01.Nr.20203, të datës 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, me qëllim të ndarjes së hapësirave, funksionalizimeve dhe instalimeve në objektin e ri të Shkollës Profesionale të IAAP "Andrea Durrsaku", Kryetari i Komunës së Kamenicës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E PROJEKTIT DHE PARAMASËS TEKNIKE PËR NDARJEN E HAPËSIRAVE, RREGULLIMIN E FURNIZIMEVE DHE INSTALIMEVE NË OBJEKTIN E RI TË SHKOLLËS PROFESIONALE TË IAAP "ANDREA DURRSAKU"

1. Formohet Komisioni për hartimin e projektit dhe paramasës teknike për ndarjen e hapësirave, rregullimin e furnizimeve dhe instalimeve në objektin e ri të Shkollës Profesionale të IAAP "Andrea Durrsaku".

2. Komisioni ka këtë përbërje:

   2.1. Mehmet Thaqi, (Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor) – Kryesues;
   2.2. Besart Fejzullahu, (Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor) – Anëtar; dhe
   2.3. Shaban Lenjani, (Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjenca) – Anëtar.

3. Komisioni ka për detyrë hartimin e projektit dhe parametrave teknikë për ndarjen e hapësirave, rregullimin e furnizimeve dhe instalimeve në objektin e ri të Shkollës Profesionale të IAAP "Andrea Durrsaku". Gjatë hartimit të projektit, Komisioni do të zhvillojë konsultime me Drejtorinë Komunale të Arsimit.

4. Projekti dhe paramasa teknike duhet të hartohen dhe dorëzohen brenda një afati prej 20 ditësh pune.

5. Mandati i Komisionit për hartimin e projektit dhe paramasës teknike për ndarjen e hapësirave, rregullimin e furnizimeve dhe instalimeve në objektin e ri të Shkollës Profesionale të IAAP "Andrea Durrsaku", përfundon me dorëzimin e projektit dhe paramasës.

6. Zbatimin e këtij Vendimi e bën Komisioni, sipas pikës (1) të këtij Vendimi, ndërsa mbikëqyrjen e zbatimit e bëjnë Kryetari i Komunës dhe Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm

dhe Planifikim Hapësinor.

7. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendim t`i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Anëtarëve të Komisionit;
- Drejtorisë Komunale të Arsimit;
- z. Uran Berisha (DUPH); dhe
- QSHQ – Arkivit

Kryetar i Komunës

Kadri Rahimaj